

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6211
E martë, 12 janar 2021
çmimi 0.40 €

FLET PËR "EPOKËN E RE",
AFARISTI BURIM PIRAJ
**Afarizmi në Kosovë
përballet me vështirësi
tatimore** | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RESHJET E FUNDIT KANË SHKAKTUAR PËRMBYTTJE TË MËDHA NË KOSOVË | FAQE 4-5

VËRSHIME TË MËDHA, QEVERIA PARALAJMËRËN FOND EMERGJENT



Disa komuna të Kosovës janë prekur nga vërshimet që kanë ndodhur si pasojë e reshjeve të mëdha të borës dhe shiut në ditët e fundit. Dëmet janë jashtëzakonisht të mëdha në ekonomi familjare, biznese, kultura

bujqësore dhe në infrastrukturë. Në mëngjesin e të hënës, fshatra, lagje dhe familje të tëra janë zgjuar të përmbytura në uji, ku është dashur intervenimi i FSK-së për evakuimin e tyre. Zonat më të prekura janë

komuna e Fushë-Kosovës, Drenasit, Malishevës dhe Klinës. Qeveria e Kosovës ka premtuar themelimin e një fondi emergjent për t'u dalë në ndihmë zonave të prekura nga vërshimet

IKSHPK-ja BËN THIRRJE PËR RESPEKTIM TË MASAVE KUNDËR COVIDIT

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka theksuar se duke pasur parasysh vlerësimin e situatës aktuale me Covid-19, ka përsërit-

ur thirrjen për zbatimin e të gjitha masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga virusi Covid. Sipas IKShPK-së, grumbullimi i qytetarëve pa

maska dhe pa mbajtje të distancës shton rrezikun e përhapjes së infeksionit përdërisa ky virus është i pranishëm në mesin tonë | FAQE 3



NIS VAKSINIMI KUNDËR COVID-19 NË SHQIPËRI | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

**PO TË ISHTE GJALLË REXHEP
MALA, KOSOVA DO TË DUKEJ
NDRYSHE** F. 10

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE

**KQZ-ja KUFIZON SHPENZIMET E
PARTIVE PËR FUSHATË** F. 7

**PROFESOR ARBEN FETOSHI
I BASHKOHET PDK-SË** F. 6



EKONOMI

**HOTI INSPEKTON PUNIMET
PËR REHABILITIMIN E LINJËS
HEKURUDHORE 10** F. 9

**TELEKOMI I KOSOVËS: QEVERIA
PO RREZIKON FUNKSIONIMIN E
NDËRMARRJES** F. 9



SPORT

**XHUDISTET RRËMBEJNË TRI
MEDALJE NË KATAR** F. 12



Rama fton Turqinë dhe Greqinë për bisedime lidhur me krizën në Mesdhe

TIRANË, 11 JANAR - Ministri i Jashtëm i Turqisë, Mevlut Cavusoglu, ka pranuar ftesën e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, për ta takuar homologun grek, Nikos Dendias, në Tiranë, për të biseduar për një zgjidhje të mundshme për Mesdheun Lindor, e cilësuar si një nga krizat më të thella mes dy shteteve në dekadat e fundit. Cavusoglu ka deklaruar se kryeministri Rama donte ta sillte atë së bashku me ministrin e Jashtëm grek, Niko Dendias, në Tiranë, por Dendias hyri në karantinë gjatë kësaj periudhe. "Unë jam gati të shkoj për takimin në Tiranë, me ftesë të Ramës", tha ai.

Lajmin e kanë bërë me dije mediat turke, duke thënë se ministri i Jashtëm i Turqisë ka biseduar në telefon me kryeministrin Rama dhe ka pranuar ftesën për një organizim joformal të bisedimeve mes dy vendeve të tensionuara.

Përgjigja nga Turqia vjen disa ditë pas vizitës së kryeministrit Edi Rama në Ankara, ku është pritur nga presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan. Rama, më pas, ka vizituar edhe Greqinë, ku është pritur nga kërret e lartë të vendit.

Tensionet në Mesdheun Lindor kanë qenë temë e disa vizitave të sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, gjatë të cilave ai ka shprehur shqetësimin e Shteteve të Bashkuara për veprimet e Turqisë dhe u ka bërë ftesë palëve që ta zgjidhin kontestin me rrugë diplomatike.

Turqia dhe Greqia nuk kanë marrëdhënie për delimitimin detar mes tyre dhe Turqia nuk e njeh sovranitetin e Qipros mbi ujërat detare.

Ky është konfirmimi i parë për takim mes dy palëve qëkur filluan tensionet në korrik të vitit 2020 dhe hera e parë që Shqipëria mund të luajë rol në ndërmjetësimin mes dy



shteteve, me të cilat ka marrëdhënie të mira diplomatike, për të tejkaluar një krizë me karakter ndërkombëtar.


Tensionet në mes të Turqisë dhe Greqisë, që të dyja shtete anëtare të NATO-s, kanë filluar në verën e vitit të kaluar rreth eksplorimit të gazit natyror në

Detin Mesdhe. E përfshirë në këtë eksplorim është edhe Qiproja, vend anëtar i BE-së, dhe një sërë shtetesh të tjera mesdhetare të cilat janë pjesë e një përpjekjeje për të ndërtuar një gazsjellës të ri, si burim të mundshëm alternativ për furnizimin e Evropës me gaz natyror dhe zvogëlimin e

dominimit të gazit rus në kontinentin evropian.

Kësaj përpjekjeje, Turqia iu përgjigj me dërgimin e anijes së saj eksploruese, duke përkeqësuar marrëdhëniet me Greqinë dhe Francën, e cila kishte kërkuar nga Bashkimi Evropian sanksione të ashpra ndaj Turqisë.

Bideni zgjedh William Burnsin për shef të CIA-s



NYU-JORK, 11 JANAR - Presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, njoftoi se ka zgjedhur diplomat veteran William Burns për drejtor të CIA-s. Burns, 64 vjeç, ish-ambasador në Rusi dhe Jordani, ka karrierë 33-vjeçare në Departamentin amerikan të Shtetit, edhe nën udhëheqjen e presidentëve republikanë, edhe atyre

demokratë. "Bill Burns është një diplomat shembullor me disa dekada përvojë në skenën botërore. Ai ndan bindjen time të thellë se intelijenca duhet të jetë jopolitike dhe se profesionistët e përkushtuar të inteligjencës që i shërbejnë kombit tonë, meritojnë mirënjohje dhe respekt", ka thënë Bideni.

Britania do të hapë qendra masive vaksinimi kundër Covidit

LONDËR, 11 JANAR - Mijëra persona do të vaksinohen këtë javë kundër Covid-19 në Britani, teksa pritet të hapen shtatë qendra të mëdha në gjithë territorin britanik. Shërbimi Kombëtar i Shëndetit në Britani të Madhe ka thënë

se qindra shërbime të tjera spitalore do të jenë të qasshme më vonë gjatë kësaj jave. Qeveria britanike synon të vaksinonjë 15 milionë persona në Mbretëri të Bashkuar, ata mbi moshën 70-vjeçare, punëtorët shëndetësorë dhe

atyre që u duhet mbrojtje deri në mesin e muajit shkurt. Autoritetet shëndetësore në Britani kanë paralajmëruar se javët në vazhdim do të jenë "më të rëndat e pandemisë" për Shërbimin Kombëtar të Shëndetit.



Gripi i shpendëve përhapet në shumë shtete të Indisë

NEW DELHI, 11 JANAR - Gripi i shpendëve është përhapur në shumë shtete të Indisë si dhe në kryeqendrën New Delhi. Delhi dhe Maharashtra, me një popullsi prej 114 milionë qytetarësh, janë në mesin e

nëntë shteteve që deri tani kanë regjistruar praninë e gripit të shpendëve, ku autoritetet doemos duhej të ndërmerrnin masa për ta parandaluar përhapjen e mëtejshme. Sipas medias së huaj, që nga e diela gripi u

paraqit edhe në shtetet Kerala, Rajasthan, Madhya Pradesh, Himachal Pradesh, Haryana, Gujarat dhe Uttar Pradesh, por të hënën testet konfirmuan se ky lloj i gripit është përhapur edhe në rajone të tjera.



Edhe gjashtë të vdekur dhe 206 raste të reja me Covid në Kosovë

IKShPK-ja bën thirrje për respektim të masave kundër Covidit

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka theksuar se duke pasur parasysh vlerësimin e situatës aktuale me Covid-19, ka përsëritur thirrjen për zbatimin e të gjitha masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga virusi Covid. Sipas IKShPK-së, grumbullimi i qytetarëve pa maska dhe pa mbajtje të distancës shton rrezikun e përhapjes së infeksionit përderisa ky virus është i pranishëm në mesin tonë



dhe inspektoratet përgjegjëse, që ta mbikëqyrin me përpikëri dhe t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për

zbatimin e masave dhe vendimeve të tjera në fuqi në zbatim të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e

pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës", është theksuar në komunikatën e IKShPK-së.

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 JANAR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 281 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 206 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar gjashtë raste të të vdekurve me këtë virus.

Rastet e të vdekurve janë nga komuna: Fushë-Kosovë dy raste (71, 74 vjeç), Prishtinë dy raste (77, 72 vjeç), Mitrovicë një rast (74 vjeç), Prizren një rast (73 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 53 982 raste nga 198 342 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 383 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 389 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 46 648 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 5 951.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 54 raste, Podujevë 18 raste, Mitrovicë 17 raste, Lipjan 15 raste, Ferizaj 13 raste, Fushë-Kosovë 13 raste, Pejë 11 raste, Vushtrri 10 raste, Gjakovë 8 raste, Drenas 6 raste, Gjiilan 5 raste, Malishevë 5 raste, Rahovec 4 raste, Suharekë 4 raste, Kaçanik 3 raste, Klinë 3 raste, Obiliq 3 raste, Skenderaj 3 raste, Deçan 2 raste, Istog 2

raste, Shtime 2 raste, Shtërpçë 2 raste dhe me nga një rast komunat Kamenicë, Prizren dhe Viti.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) në komunikatën për media ka theksuar se duke pasur parasysh vlerësimin e situatës aktuale me Covid-19, ka përsëritur thirrjen për zbatimin e të gjitha masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia. "IKShPK apelon te të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat publike dhe private, për respektimin dhe ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për parandalimin, menaxhimin dhe kontrollin e infeksionit Covid-19, duke marrë parasysh dispozitat e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 dhe vendimet në fuqi mbi masat dhe obligimet e institucioneve për zbatimin e masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19. Në veçanti, bëjmë thirrje për zbatimin e rekomandimeve dhe respektimin e masave kufizuese për aktivitetet publike, përkatësisht kufizimeve për grumbullimin e qytetarëve dhe tubimeve publike", është thënë në komunikatën e IKShPK-së.

Sipas IKShPK-së, grumbullimi i qytetarëve pa maska dhe pa mbajtje të distancës shton rrezikun e përhapjes së infeksionit përderisa ky virus është i pranishëm në mesin tonë. "Apelojmë tek institucionet përgjegjëse, përkatësisht Policia e Kosovës

FOTOLAJM

Nis vaksinimi kundër Covid-19 në Shqipëri

TIRANË, 11 JANAR- Në Shqipëri ka nisur të hënën vaksinimi kundër sëmundjes Covid-19, ku të parët që do ta marrin këtë shërbim janë punëtorët shëndetësorë, që

do të pasohen nga policët dhe shërbyesit e tjerë publikë, si dhe të moshuarit apo grupet që konsiderohen më të rrezikuara. Në mesin e personave të parë që u

vaksinuan ishte kryeministri Edi Rama, drejtoresha e spitalit infektiv të Tiranës, Najada Çomo dhe mjeku infektolog, Pëllumb Pipero.

Ish-deputetja Shukrije Bytyqi kalon në AAK, bëhet pjesë e listës për deputete

PRISHTINË, 11 JANAR (ER) - Ish-deputetja Shukrije Bytyqi i është bashkuar të hënën Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Bytyqin e ka pritur në zyrat e AAK-së lideri i kësaj partie Ramush Haradinaj.

Ky i fundit ka bërë me dije se Shukrije Bytyqi do të jetë pjesë

e listës së AAK-së për deputete në zgjedhjet e 14 shkurtit. "Nga sot familjes sonë të përbashkët politike iu bashkua edhe ish-deputetja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj. Shukrije Bytyqi. Ajo ka përfunduar studimet master në shkencë natyrore dhe do të jetë pjesë e listës së

AAK-së për zgjedhjet e parakohshme, me propozim të Degës së Aleancës në Malishevë. Znj. Shukrije, mirë se erdhe në Aleancë!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Shukrije Bytyqi më herët ka qenë pjesë e Nismës Socialdemokrate.





RESHJET E FUNDIT KANË SHKAKTUAR PËRMBYTJE TË MËDHA NË KOSOVË

Vërshime të mëdha, qeveria paralajmëron fond emergjent

Disa komuna të Kosovës janë prekur nga vërshimet që kanë ndodhur si pasojë e reshjeve të mëdha të borës dhe shiut në ditët e fundit. Dëmet janë jashtëzakonisht të mëdha në ekonomi familjare, biznese, kultura bujqësore dhe në infrastrukturë. Në mëngjesin e të hënës, fshatra, lagje dhe familje të tëra janë zgjuar të përmbytura në uji, ku është dashur intervenimi i FSK-së për evakuimin e tyre. Zonat më të prekura janë komuna e Fushë-Kosovës, Drenasit, Malishevës dhe Klinës. Qeveria e Kosovës ka premtuar themelimin e një fondi emergjent për t'u dalë në ndihmë zonave të prekura nga vërshimet

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 11 JANAR - Reshjet e shumta të borës dhe shiut kanë shkaktuar përmbytje të mëdha në disa pjesë të Kosovës. Zonat më të prekura janë komuna e Fushë-Kosovës, Drenasit, Malishevës dhe Klinës. Pavarësisht prej dëmeve të mëdha që janë shkaktuar në ekonominë familjare, infrastrukturë, deri më tani nuk ka pasur ndonjë viktimitë.

Nga reshjet që kanë zgjatur disa ditë, mëngjesi i së hënës i ka zbardhur dhjetëra familje në disa komuna të bllokua nga uji. Në evakuimin e këtyre familjeve ka ndihmuar Forca e Sigurisë së Kosovës dhe shërbimet e zjarrfikësve.

Përmbytjet kanë shkatërruar edhe rrugë dhe disa ura. Sipas autoriteteve lokale, dëmet nga vërshimet janë jashtëzakonisht të mëdha, ndërsa Qeveria e Kosovës ka premtuar ndihmë.



Taulant Qenaj (RFE/RL)

Gjatë një vizite në fshatin Dobroshec të Komunës së Drenasit, kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka deklaruar se do të evidentohen dëmet që janë shkaktuar nga vërshimet, në mënyrë që të kompensohen qytetarët. Ai ka paralajmëruar themelimin e një fondi emergjent për këtë çështje. "Jam duke e përcjellë situatën me vërshimet, gjendje vërtet e rëndë. Është mirë që nuk kemi pasur viktima. Dëme janë shkaktuar mjaft shumë. Po kujdesemi që të intervenojmë aty ku gjendja është më emergjente. Do të themelojmë një fond emergjent për t'u dalë në ndihmë familjeve që kanë pasur dëme në shtëpi dhe që janë në kushte të

këqija. Me shtabe lokale do ta bëjmë vlerësimin e dëmeve se si t'u dalim në ndihmë atyre", ka thënë Hoti gjatë vizitës në fshatin Dobroshec.

Ndërsa ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka bërë me dije për aksionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës për t'i evakuuar banorët. "Angazhimi i parë ka ndodhur në rajonin e Gjakovës që janë evakuuar disa familje dhe kemi pasur angazhime të tjera në rajonin e Fushë-Kosovës, Guri i Zi (Komuna e Klinës), kemi ndihmuar Klinikën e Pulmologjisë, Qendrën e Forenzikës dhe një ekip është në rajonin e Vushtrrisë", ka thënë ai. Për ta përcjellë nga afër situatën pas vërshimeve në ditët e fundit,

kryeministri Hoti ka vizituar Qendrën e Situatave. Në takim me drejtorin e kësaj qendre, Shaqir Shaqiri, dhe sekretarin e Sekretariatit për Siguri, Shpend Tërdevaj, Hoti ka diskutuar për masat që duhet të ndërmerren me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të situatës së krijuar. "Institucionet e Kosovës janë duke e përcjellë nga afër situatën dhe të gjitha kapacitetet shtetërore janë vënë në gjendje gatishmërie, përfshirë këtu Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, shtabet lokale dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Po ashtu, kryeministri Hoti është në komunikim edhe me komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Franco Federici, i cili ka shprehur gatishmërinë për ta ofruar ndihmën e forcës paqeruajtëse nëse një gjë e tillë do të jetë e nevojshme", është thënë në njoftimin për media të Zyrës së Kryeministrit.

Kryetarët e komunave vizitojnë zonat e vërshuara

Kryetarët e komunave të prekura nga vërshimet kanë dalë në terren për t'i parë nga afër zonat e prekura nga vërshimet. Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, menjëherë pas formimit të Qendrës Operative Emergjente, ka dalë në terren për t'i parë nga afër dëmet e shkaktuara nga të reshurat e shiut. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve që të jenë bashkëpunues dhe të kenë mirëkuptim për ta tejkaluar këtë gjendje të krijuar nga vërshimet. Në këtë komunë janë evakuuar gjashtë familje dhe janë vendosur



në hotelet e qytetit, ndërsa ekipet emergjente, FSK-ja, policia dhe aktorë të tjerë, që nga orët e hershme të mëngjesit janë në terren për t'i ndihmuar qytetarët. Pas reshjeve të mëdha të shiut e borës edhe në Gjilan janë shkaktuar vërshime në disa pjesë. Kryetari i kësaj komune, Lutfi Haziri, ka dalë në terren për ta parë gjendjen nga afër. Ai ka bërë me dije se ka themeluar grupin punues për menaxhimin e situatës ku, pos institucioneve të komunës, do të jenë të përfshira edhe KRU Hidromorava, Policia e

Kosovës dhe FSK-ja. Ai ka thënë se gjendja po menaxhohet me të gjitha mundësitë komunale dhe në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera. Edhe kryetarët e disa komunave të tjera kanë dalë në terren për ta parë nga afër gjendjen e vërshimeve. Ata kanë vënë në funksion të gjitha kapacitetet komunale, ekipet emergjente të komunave, shërbimin e zjarrfikësve dhe kompaninë e kontraktuar për këto raste për t'u dalë në ndihmë banorëve të prekur nga vërshimet.

Për shkak të vërshimeve, bllokohen disa rrugë

Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar rreth gjendjes aktuale të rrugëve në vend. Përmes një njoftimi për media, është bërë me dije se në rrugën Prishtinë - Pejë, N9 te "Kroni i Mbretit", është bllokuar rruga për shkak të ujërave, mirëpo është intervenuar dhe është zhbllokuar nga kompanitë e mirëmbajtjes dhe policia është në vendin e ngjarjes.

Ndërkaq në regjionin e Gjilanit 2, rruga R 124, drejtimi Kamenicë - Strezovc, është e bllokuar për shkak të dëmtimit të urës nga vërshimet e ujit. "Në pjesën dalëse të auto-udhës R7 ('Ibrahim Rugova'), në Mazgit, që lidhet me rrugën nacionale N2, kemi plasaritje (deformim) të rrugës, është sinjalizuar ajo pjesë e rrugës dhe po kujdeset kompania e mirëmbajtjes që komunikacioni të lehtësohet. Në pjesën Gjilani 1 gjendja e rrugëve është e mirë, ka pasur të reshura të shiut dhe si pasojë ka pasur erodime të gurëve, është intervenuar në largimin e tyre në të gjitha drejtimet. Ka vështirësi

gjatë qarkullimit të automjeteve, por me kujdes të shtuar mund të kalohet", ka njoftuar Ministria e Infrastrukturës.

Kurse në pjesën Ferizaj 1, rruga Brezovicë - Sharr, ka pasur dy pengesa në të cilat është intervenuar nga ekipet e mirëmbajtjes. "Punimet që janë zhvilluar dhe vazhdojnë në vendosjen e disa gypave për ndërtimin e një hidrocentrali përgjatë kësaj rruge, në këtë vit (2020) kanë bërë që të ngushtohet trupi i rrugës, parkingjet që kanë qenë janë dëmtuar, mirëpo rruga është e kalueshme me kujdes të shtuar. Si pasojë e këtyre dy problemeve të lartshënuara, intervenimi është bërë shumë i vështirë, pothuajse i pamundur. Problem tjetër është mungesa e parkingjeve dhe si pasojë e kësaj, automjetet parkohen në rrugë duke na bërë të pamundur në disa raste depërtimin e kompanive në atë pjesë", është theksuar në këtë njoftim.

Më tej në këtë njoftim bëhet me dije se në pjesën Gjilani 2, në



disa pjesë, për shkak të reshjeve të shiut ka erodime dhe rrëshqitje të dheut (Rr. Shpashnicë e Epërme - Desivojçë, kilometri 55-60), por që është intervenuar. "Në regjionin Peja 1 ka pasur reshje të borës, po ashtu ka edhe reshje të shiut me akull. Vazhdimisht është bërë largimi i borës dhe shpërndarja e kripës. Të gjitha rrugët janë të kalueshme. Për shkak të reshjeve të shiut dhe shkrires së borë në rrugën N2 Prishtinë-QMI, afër rrethrotullimit në QMI, ka grumbullim të ujit në shtresa

qarkulluese si pasojë e nivelimit të pronave përreth rrugës. Ne me ekipet tona, në asistim me Policinë e Kosovës, si masë preventive kemi bërë mbylljen e qarkullimit në këtë segment rrugor nga rrethrotullimi mbi hekurudhë deri në rrethrotullim të QMI-së. Po ashtu, kemi bërë hapjen e një kanali nëpër prona private në ujë nga shtresat qarkulluese, por largimi i ujit po vazhdon me një intensitet të vogël pasi që ka grumbullim të ujit edhe në pronat rreth rrugës", është thënë

në njoftimin e MI-së.

Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar se është bërë largimi i materialit të eroduar nga shtresat qarkulluese në rrugët: Veternik-Llabjan, Shtime-Carralevë, Prishtinë-Mutivodë dhe Komoran-Carralevë. "Në rrugën Ferizaj-Gjilan, konkretisht në Sojevë, ka vërshime shkak të reshurave, mirëpo kompania e mirëmbajtjes dhe Policia e Kosovës po kujdesen që t'i orientojnë shoferët në rrugë alternative", ka njoftuar kjo ministri.

Ministria e Infrastrukturës u ka bërë thirrje qytetarëve që të jenë të vëmendshëm dhe t'u përshtaten kushteve atmosferike gjatë ngasjes. "Reshjet e shiut kanë bërë që të ketë vërshime në shumë rrugë, por po punohet që qarkullimi të jetë normal. Ministria e Infrastrukturës do t'ju mbajë të informuar për çdo ndryshim", është theksuar në njoftimin për media të Ministrisë së Infrastrukturës.



Profesor Arben Fetoshi i bashkohet PDK-së

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 11 JANAR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kandidat për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka mbajtur të hënën konferencë për media, në të cilën ka prezantuar ardhjen e profesorit të gazetarisë Arben Fetoshi, i cili i është bashkuar PDK-së.

Hoxhaj, duke i uruar mirëseardhje Fetoshit, ka theksuar se bashkimi i këtij të fundit dhe personaliteteve të tjera para tij, është dëshmi e hapjes së PDK-së dhe e besueshmërisë së saj tek intelektualët. "Arben Fetoshi

është doktor i shkencave të Gazetarisë dhe aktualisht ligjeron në Universitetin e Prishtinës, gjersa më herët ka ligjruar edhe në universitete të tjera. Ai punon në 'Radio Kosovë', kurse më herët ka punuar edhe në media të tjera si 'Radio Evropa e Lirë', si dhe ka qenë redaktor e drejtor i 'Radio Kosovës'. Si student, Fetoshi ka qenë nismëtar i bashkimit mes UÇK-së dhe LKÇK-së në maj të vitit 1998. Po ashtu, Arbeni vjen nga një familje e veçantë patriotike, është nip i Ukshin Hotit, intelektualit dhe patriotit të rrallë të kombit dhe ardhja e tij në PDK është e natyrshme në një parti që është ngritur

mbi themele të shëndosha të veprimtarisë së të burgosurve politikë dhe luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare", ka thënë ai.

Më tutje, Hoxhaj është shprehur se pas një viti të dëshpërimit qytetar me partitë që e prezantuan veten si shpresë për qytetarin, por që ishin në krye të dy qeverive të dështuara, PDK-ja po rikthehet fuqishëm si adresa e vetme që shtyn përpara çështjet madhore të shtetit dhe të interesit të qytetarëve. Ai ka ftuar intelektualë të tjerë t'i bashkohen PDK-së për rimëkëmbje të dinjitetit të Kosovës. "Në këtë kohë krize ekonomike, PDK-ja është

adresa e vetme e rimëkëmbjes ekonomike. Në këtë kohë krize shëndetësore, PDK-ja është adresa e vetme e rimëkëmbjes së shëndetësisë. Në këtë kohë krize kombëtare, PDK-ja është adresa e vetme e rimëkëmbjes kombëtare. Prandaj, përmes kësaj konference i bëj thirrje intelektualëve të rinj, shkollarëve që po kthehen nga universitetet ndërkombëtare, që t'i bashkohen PDK-së në projektin e madh të rimëkëmbjes së përgjithshme të Kosovës. Sot, sikurse me aderimet e mëparshme, nuk po aderim thjesht Arbeni si emër konkret. Ky është

aderim i një fryme të re, i kërkesave nga baza, për një rimëkëmbje të dinjitetit të Kosovës. Ky është sinjal që PDK-ja po hapet ndaj ideve të reja dhe që qytetarët po e shohin si adresën e vetme që do ta mundësojë këtë rimëkëmbje", është shprehur Hoxhaj.

Arben Fetoshi, duke falënderuar Hoxhajn për pritjen, ka thënë se vendimi i tij për t'iu bashkuar PDK-së dhe ekipit të kryeministrit në ardhje është vendimi më i drejtë që ka marrë, me shpresën që sfida e zgjedhjeve të 14 shkurtit të nisë një fazë të re për politikën e vendit dhe për më shumë përkushtim.

Aktakuzë kundër pesëmbëdhjetë personave



PRISHTINË, 11 JANAR (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Speciale, kundër pesëmbëdhjetë të pandehurve me inicialet A. K., A. K., I. V., B. I., S. F., F. M., A. D., Xh. K., E. J., B. H., N. E., H. K., K. M., T. B., D. R., për veprat penale "Organizimi i

skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm", nga neni 300, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal Republikës së Kosovës (KPRK-së), "Kontrabandimi i mallrave", nga neni 317, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), "Shmangie nga tatimi", nga neni 313, paragrafi 1 lidhur me

paragrafin 3, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), dhe "Shpëlarje e parave", në kundërshtim me nenin 302, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06/L-074), lidhur me nenin 56 (1) (1.5) të Ligjit nr. 05/L-096 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit".

Betohen anëtarët e rinj të Këshillit Prokurorial të Kosovës

PRISHTINË, 11 JANAR (ER) - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka mbajtur takimin e 192-të me radhë. Ky takim, në bazë të rregullores për zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të KPK-së, është udhëhequr nga

kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, i cili njëkohësisht është anëtar i Këshillit Prokurorial sipas detyrës zyrtare. Në fillim të këtij takimi gjashtë anëtarë të rinj të KPK-së, të cilët vijnë nga radhët e prokurorive

themelore dhanë betimin, kurse takimi ka vazhduar me pikat e radhës, me ç'rast është hapur thirrja për nominime për kryesues dhe zëvendëskryesues të ri të KPK-së.

Lidhur me procedurat për

nominim në pozitat e lartcekura, të gjithë anëtarët u njoftuan nga kryeprokurori i Shtetit, Lumezi.

Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i ri i Këshillit Prokurorial të



Kosovës do të zgjidhen brenda afatit të caktuar me aktet ligjore.

Hoti paralajmëron mundësinë e kthimit të reciprocitetit me Serbinë

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 JANAR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka paralajmëruar se procesi i dialogut me Serbinë duhet të përfundojë me një marrëveshje përfundimtare për njohje reciproke ose, në të kundërtën, Kosova do t'i zbatojë të gjitha masat e reciprocitetit me Serbinë. "Të gjitha pa përjashtim, të gjitha masat që Serbia i drejton nga ne, ne kemi të drejtë dhe do t'i drejtojmë kah Serbia", ka thënë Hoti pas një takimi me përfaqësues të shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Megjithatë, Hoti tha se beson që me përfshirjen e "partnerëve ndërkombëtarë që kemi arritur në këtë proces" nuk do të ketë nevojë të që aplikohen këto masa ekstreme pasi, sipas tij, çdo ditë po bëhet përparim drejt marrëveshjes përfundimtare me Serbinë.

Kryeministri në detyrë i Kosovës i bëri këto komente pasi u pyet se si do të veprojë

Kosova në rast se Serbia pengon dërgimin e librave shkollorë për shqiptarët në Luginën e Preshevës, të cilat institucionet e Kosovës parashohin t'i dërgojnë në këtë pjesë të Serbisë gjatë këtij viti.

Dërgimi i librave, por edhe një sërë projektesh të tjera, janë paraparë në programin e Zyrës për Luginën e Preshevës, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së kryeministrit të Kosovës. Në kuadër të këtij programi parashihet ndihma për organizatat joqeveritare në Luginën e Preshevës, pastaj ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe projekte të tjera, përfshirë edhe një studim për gjendjen sociale dhe ekonomike të shqiptarëve në Luginën e Preshevës.

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, ka nisur më 2011. Ai u ndërpre për 20 muaj, nga fundi i vitit 2018 për shkak të taksës 100 për qind që Kosova vendosi ndaj produkteve nga



Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, nga qeveria e udhëhequr në atë kohë nga Ramush Haradinaj. Më pas, qeveria e ardhshme e Albin Kurtit e hoqi tarifën, por vendosi masat e reciprocitetit. Serbia kundërshtonte të ulej në tryezë të bisedimeve, derisa Kosova kishte në fuqi

masa të tilla. Me ardhjen në pushtet, qeveria e udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti shfuqizoi reciprocitetin, duke mundësuar rifillimin e dialogut në korrik të 2020-s. Ka disa muaj që Hoti dhe presidenti i Serbisë, Vuçiq, nuk kanë zhvilluar raunde të

reja të bisedimeve. Nga BE-ja është thënë se takimet në nivel politik nuk po mbahen për shkak të pandemisë së koronavirusit. BE-ja ka thënë se ky proces ka për qëllim normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit zyrtar.

KQZ-ja kufizon shpenzimet e partive për fushatë



PRISHTINË, 11 JANAR (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, në të cilën ka marrë vendim për kufizimin shpenzimeve për partitë politike për fushatë zgjedhore. KQZ-ja ka bërë me dije se një parti politike mund të shpenzojë deri në 934 mijë e 831 euro, që i bie 0.5 euro për votues të regjistruar.

Po në këtë mbledhje u bë me dije se të martën është afati i fundit kur partitë mund të deklarohen për koalicionet

parazgjedhore.

Certifikimi i partive politike ka filluar nga 8 janari dhe do të zgjasë deri më 21 janar, kurse tërheqja e shortit për renditjen e subjekteve politike dhe kandidatëve në fletëvotim do të mbahet më 1 shkurt 2021.

Fushata zgjedhore do të jetë nga data 3 shkurt deri më 12 shkurt 2021, ndërsa zgjedhjet e parakohshme parlamentare do të mbahen më 14 shkurt.

Buxheti për zgjedhjet e 14 shkurtit do të jetë 5 milionë e 650 mijë euro.

Osmani në Bruksel, takon zyrtarët e lartë të BE-së

PRISHTINË, 11 JANAR - Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ndodhet në Bruksel, ku do të ketë takime me zyrtarë të Belgjikës si dhe të institucioneve të Bashkimit Evropian.

Osmani pritet ta takojë të martën presidentin e Parlamentit Evropian, David Sasoli, dhe komisionarin e BE-së për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliver Varhelyi.

BE-ja i ka konfirmuar këto takime, por nuk ka dhënë hol-

lësi rreth temave që pritet të diskutohen. Sipas burimeve të BE-së, pritet që të flitet për situatën aktuale në Kosovë për procesin zgjedhor, për përballjen me pandeminë e koronavirusit, si dhe për dialogun me Serbinë.

Kosova do të mbajë zgjedhje të parakohshme parlamentare më 14 shkurt.

Sa i përket këtij procesi zgjedhor, në BE janë shprehur më herët se presin që ai të jetë transparent, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me stan-

dardet evropiane.

BE-ja pret që edhe pas zgjedhjeve, pa marrë parasysh se kush do ta formojë qeverinë e ardhshme, Kosova ta vazhdojë përkushtimin për dialog me Serbinë, të cilin e lehtëson vetë BE-ja.

Në takimet e Osmanit me zyrtarë të BE-së pritet të flitet edhe për ndihmën që i ofron Bashkimi Evropian Kosovës në përballje me pandeminë e koronavirusit, e sidomos për përgatitjen për fushatën e vaksinimit.



Flet për “Epokën e re”, afaristi Burim Piraj

Afarizmi në Kosovë përballet me vështirësi tatimore



konsideron edhe problemin me energji elektrike ku, sipas tij, kjo po ndikon edhe mosardhjen e investorëve të huaj. Ai ka theksuar se Kosova nuk ka arritur t'i bëjë reformat e kërkuara dhe të duhura në përmirësimin e ambientit të biznesit, në mënyrë që të mundësohen investimet e huaja të drejtpërdrejta, sidomos në përpunim dhe prodhimtari.

Duke folur për kompaninë që drejton “Meka Halal Food”, Burim Piraj ka thënë se, pavarësisht prej vështirësive që kanë pasur, vitin 2020 e kanë përmbyllur me bilanc pozitiv. “Jemi ballafaquar me situata shumë të vështira me të cilat nuk jemi mësuar të merremi. Me shumë kufizime dhe me shumë probleme të papritura, mirëpo prapëseprapë e falënderoj Zotin që na ka mundësuar ta menaxhojmë disi situatën dhe përfundimisht ta përmbyllim dhe këtë vit me bilanc pozitiv”, ka thënë Piraj. Ai ka thënë se Kosovës i duhen njerëz të duhur në institucione, të cilët kanë dije dhe guxim për t'i lëvizur çështjet përpara.

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 JANAR - Biznesmeni i njohur nga Kosova, pronar i kompanisë “Meka Halal Food”, Burim Piraj, ka thënë se afarizmi në vendin tonë përballet me sfida tatimore. Ai rast konkret ka përmendur ndryshimin e ligjit të TVSh-së, pagesën e TVSh-së për lëndën e parë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, Piraj sfidë e

“Epoka e re”: Z. Piraj, si e ka përmbyllur kompania juaj vitin 2020?

Piraj: Viti 2020 do të mbahet në mend si vit i pandemisë i cili ka shkaktuar probleme si në ekonomi, po ashtu edhe në të gjitha sferat e jetës. Jemi

Afaristi i njohur nga Kosova, pronar i kompanisë “Meka Halal Food”, Burim Piraj, ka thënë se Kosova nuk ka arritur t'i bëjë reformat e kërkuara dhe të duhura për përmirësimin e ambientit të biznesit në mënyrë që të mundësohen investimet e huaja të drejtpërdrejta, sidomos në përpunim dhe prodhimtari. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se afarizmi në vendin tonë përballet me sfida tatimore. Duke folur për kompaninë që drejton “Meka Halal Food”, Piraj ka thënë se, pavarësisht prej vështirësive që kanë pasur, vitin 2020 e kanë përmbyllur me bilanc pozitiv

Telekomi i Kosovës: Qeveria po rrezikon funksionimin e ndërmarrjes

PRISHTINË, 11 JANAR (ER) - Marrëveshja e fundit për zhbllokimin e llogarive të Telekomit dhe shlyerjen e obligimeve ndaj “Z-Mobile” me ndërmjetësim të Qeverisë ka rënduar gjendjen financiare në korporatë.

Kështu ka njoftuar Telekom i Kosovës përmes një reagimi, duke shtuar se edhe pse ndërmarrja ka negociuar për shumë kohë me ‘Z-Mobile’ për arritjen e marrëveshjes për shlyerjen e obligimeve nuk ka mundur të arrijë asnjë marrëveshje pa ndërmjetësim dhe garanci të qeverisë. “Kushtet e Telekomit për arritjen e marrëveshjes kanë qenë që shlyerja e obligimeve të bëhet gjatë katër vjetëve të ardhshme ndërsa që qeveria



është pajtuar që ky afat të ulet në dy vjet, pra kushti kryesor është negociuar dhe vendosur nga vetë qeveria. Por edhe pse qeveria ka dhënë garanci se do ta ndihmojë Telekomin që ta

tejkalojë këtë situatë dhe të mos ketë ngecje në përmbylljen e kësaj marrëveshjeje deri më tash edhe përkundër insistimit tonë dhe premtimeve të saj nuk

është marrë asnjë veprim. Mospërkrahja e qeverisë do të thotë që llogaritë e Telekomit mund të bllokohen përsëri qysh këtë javë, ndërsa punëtorët do të mbesin pa paga e familjet e tyre do të futen në varfëri. Kjo neglizhencë e qeverisë rrezikon edhe sigurinë kombëtare pasi rënia e shërbimeve të Telekomit rrezikon funksionimin e gjithë institucioneve të sigurisë”, thuhet në reagim.

Telekomi ka njoftuar se bordi dhe menaxhmenti janë angazhuar maksimalisht për kryerjen e obligimeve të veta duke siguruar që të ketë rritje të vazhdueshme të të hyrave dhe të krijojë stabilitet financiar megjithëkëtë pa përkrahjen e

qeverisë në këto çaste kjo nuk mjafton. “Telekomi ka përfillur në vazhdimësi gjithë kërkesat e aksionarit, duke përfshirë uljen e pagave deri në 60 për qind, ka ulur të gjitha shpenzimet operative deri në masën ku nuk rrezikohen operimet tona, është në përfundim të procesit të ristrukturimit gjitha këto me qëllim të krijimit të stabilitetit në kompani. Gjithë punonjësit e Telekomit, bordi dhe menaxhmenti i bëjnë thirrje qeverisë për reagim të menjëhershëm me qëllim që të mos lejohet shkatërrimi i kompanisë, të mos rrezikohet ekzistenca e më shumë se 3 000 punëtorëve dhe familjeve të tyre dhe të mos cenohet siguria jonë kombëtare”, është theksuar në këtë reagim.

ballafaquar me situata shumë të vështira, me të cilat nuk jemi mësuar të merremi. Me shumë kufizime dhe me shumë probleme të papritura, mirëpo prapëseprapë e falënderoj Zotin që na ka mundësuar ta menaxhojmë disi situatën dhe përfundimisht të përmbylim edhe këtë vit me bilanc pozitiv.

“Epoka e re”: *Ju shpesh keni pasur vërejtje në ambientin e biznesit në Kosovë. Çfarë do të ndryshonit ju?*

Piraj: Kosova nuk ka arritur t'i bëjë reformat e kërkuara dhe të duhura që ambienti i biznesit të përmirësohet dukshëm dhe të mundësohen investimet e huaja të drejtpërdrejta, sidomos në përpunim dhe prodhimtari. Këtu i kemi dy aspekte shumë të rëndësishme. E para ka të bëjë me politikatatimore në vend, e dyta me sigurimin e infrastrukturës së sigurt për punë që investitorët të ndihen të sigurt. Çështja e parë ka të bëjë me ndryshimin e ligjit të TVSh-së dhe mundësimin e qarkullimit, pra tregtimit të mallit brenda kompanive pa TVSh. TVSh-ja duhet të paguhet pasi të jetë shitur malli. Lënda e parë duhet të jetë e liruar nga çdo taksë dhe nga TVSh-ja. Kompanitë prodhuese duhet të mos paguajnë TVSh ashtu siç nuk paguajnë në shumicën e vendeve të botës. Firmat prodhuese i paguajnë shtetit tatimin në paga, sigurimet, tatimin në fitim apo dividendin që po praktikojnë ta quajnë shumëkush kohët e fundit, por nuk ka detyrim të TVSh-së dhe nuk ka taksë doganore për lëndë të parë për t'u paguar. Faturimi nga kompanitë



prodhuese përherë bëhet pa TVSh dhe nga vlera zero i shtohet TVSh-ja nga kompanitë tregtare. Kur të shitet malli i paguhet TVSh-ja shtetit. Këtu në Kosovë kompanitë prodhuese e paguajnë avancë TVSh-në dhe në një mënyrë në vend se shteti ta subvencionojë prodhimin, prodhuesit e subvencionojnë buxhetin e shtetit. Kjo është një praktikë shumë e mbrapshtë e cila ka bllokuar zhvillimin e vendit. Më besoni se herët e kam kërkuar një gjë të tillë, mirëpo individët pa vizion kanë ardhur në pushtet dhe në emër të tejkallimit të keqpërdorimit të TVSh-së i kanë bllokuar reformat. Ata e kanë tejkalluar

keqpërdorimin, por e kanë bllokuar zhvillimin e vendit. Në vend se të ofronim punësim këtu, ne e shpërngulëm rininë dhe tërë vendin për të siguruar një vend pune diku anekënd botës. E dyta infrastruktura. Sot e kësaj dite në Kosovë nuk ka furnizim të rregullt me energji elektrike dhe as telefonia e as interneti nuk janë në një funksionim të mirëfilltë. Në shumë pjesë të vendit telefoni mobil nuk punon ose nuk ka rrjet të mjaftueshëm dhe në shumë pjesë të vendit nuk ka qasje në internet 4G ose edhe më të mirë se ai. Paramendoni kur në autoudhë e pranoni një telefonatë gjatë rrugës mund të ndërpritet disa herë për shkak të

rrjetit të dobët dhe të pasigurt të telefonisë, dhe tërë këto nuk vërehen nga askush. Nga ana tjetër ne vëzhgojmë se si firmat evropiane dhe turke investojnë në Serbi e gjetiu. Ndërkaq askush nuk po na vjen në Kosovë, jo pse neve nuk na duan, por pse ne jemi larg shumë nga ajo që ofrojnë të tjerët për investitorët e huaj, njëkohësisht ofrojnë edhe për firmat e tyre vendore.

“Epoka e re”: *Z. Piraj, tashmë vendi është në një proces zgjedhor. Cili është mesazhi juaj si afarist?*

Piraj: Mesazhi im këtë herë është më shumë për partitë politike të cilave nuk po iu interesojnë

shumë brengat e qytetarëve, por ato duhet ta dinë se kanë obligim ndaj familjeve të tyre, ndaj fëmijëve të tyre dhe ndaj atyre që të punojnë për këtë vend. Pra, të kujdesen për paranë publike sikurse për paranë e vet. Kosova është në stacionin e fundit për momentin. Po e kapi këtë stacion, do të ecë para, po nuk e kapi këtë stacion, rrezikon shumë dhe do të kemi pasoja edhe më të mëdha në të ardhmen. Kosovës i duhen njerëz të duhur në institucione të cilët kanë dije dhe guxim për t'i lëvizur çështjet përpara. Tani është luftë më e madhe se me armatim, luftë që duhet të fitohet medoemos me dije dhe me përkushtim.

Hoti inspektion punimet për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10

Fushë-Kosovë, 11 janar (ER) - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka përcjellë nga afër punimet për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10, ku vlerësoi progresin që është bërë në segmentin e parë. Ai nënvizoi se me fillimin e punimeve edhe në segmentin e dytë Kosova ngadalë, por sigurt po shndërrohet në një qendër ndërlidhëse jo vetëm për rajonin, por edhe më gjerë. “Unë dëshiroj ta falënderoj Bashkimin Evropian, ambasadorin, sepse një pjesë e konsiderueshme mbështeten nga ta, sigurisht BERZh-in për kushte shumë të mira të kredisë për financimin e këtij projekti. Falënderoj ministrin që e ka



shtyrë këtë projekt përpara dhe të gjithë të tjerët që me një dinamizëm po e bëjnë këtë projekt të realizohet në praktikë”, ka thënë

kryeministri Hoti. Gjatë vizitës në linjën hekurudhore 10, kryeministri Hoti ishte i shoqëruar nga ministri i Infrastrukturës,

Arban Abrashi, sekretari i përhershëm i Komunitetit të Transportit, Matej Zakonjsek, zëvendës drejtori i përgjithshëm i Transportit dhe

Lëvizjes në Komisionin Evropian, Matthew Baldwin dhe Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësues i Posaçëm i BE-së, Tomas Szunyog. Rehabilitimi i segmentit Fushë-Kosovë - Hani i Elezit, në gjatësi prej 65 kilometrash, kushton 78 milionë euro. Ndërsa kostoja e përgjithshme e rehabilitimit të hekurudhave të Kosovës do të kushtojë 210 milionë euro, të cilat do të sigurohen përmes kredive nga BERZh-i (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim). Hekurudha e Kosovës, nga Hani i Elezit deri në Leshak të Mitrovicës, do të rehabilitohet dhe modernizohet sipas standardeve më të larta evropiane.

Po të ishte gjallë Rexhep Mala, Kosova do të dukej ndryshe



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Kur me vetëflim i jep kuptim lirisë: Në kohën e vlimeve të mëdha historike, personalitetet e mëdha e që nuk pyesin për çmimin që duhet paguar për liri dhe bashkim kombëtar, kontribuojnë me një shkronjë apo edhe më shumë për plotësimin e kuptimit të fjalës liri. Ndër personalitetet e shekullit të shqiptarëve, që nga Rilindja Kombëtare e deri te lufta e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, pa asnjë dyshim është edhe Rexhep Mala i cili, si degëzim i rrënjëve kombëtare të familjes Mala, nuk mund të zhvillohej ndryshe apo të ketë tjetër përfundim si Rexhep Mala veç ashtu siç veproi dhe si përfundoi, një patriot i bindur, sakrifiku në çdo situatë që nuk njihet asnjë pengesë në rrugëtimin e veprimtarisë kombëtare, deri në kohën kur u martirizua, bashkë me Nuhi Berishën nga 11-12 janari i vitit 1984 në Prishtinë, përkatësisht në Lagjen Kodra e Trimave e që më parë quhej Vranjevc. Rexhep Mala e kishte përnjëmend që e dëshmoi me jetën, veprën dhe sakrificën që e bëri. Rexhep Mala ishte njeri i madh, shqiptar i madh dhe patriot i madh, në kuptimin e plotë të fjalës. Ishte një vazhdimësi e përpjekjeve për ruajtje të identitetit dhe qenies kombëtare, nga ilirët e deri në çastin kur u flijua në një luftë të pabarabartë me policinë serbe ku, pa asnjë dyshim kishte edhe milicë serbë që flisnin, por nuk mendonin apo frymonin shqip. Për fat të keq, këta bastardë ishin shqiptarë me mendësi serbe! Rexhep Mala kishte frymëzim luftën guerile të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, filozofinë politike dhe ushtarake të Hasan Prishtinës, guximin dhe gatishmërinë për sakrificë të Isa Boletinit, patriotizmin dhe vendosmërinë e Hoxhë Idriz Gjilanit dhe të Idriz Seferit sikur që, në një mënyrë apo tjetër, identifikohet me Çerçiz Topullin, ndërkaq që Bacën Adem Demaçi e kishte frymëzim të përhershëm, të pazëvendësueshëm dhe të pakundërshtueshëm. Mirëpo, për Rexhep Malën, Shqipëria

ishte, mbi të gjitha, dhe se, nëse në prani të Rexhep Malës, edhe në mungesë të informatave për qëndrimin e tij për Shqipërinë, e keni dhënë ndonjë kritikë, nuk keni shpëtuar lehtë nga Rexhepi, nëse keni shpëtuar fare! Në Burgun e Foçës, ku më dërguan në vitin 1981, pasi më dënuan me 3 vjet burg për propagandë armiqësore kundër Jugosllavisë, gjatë qëndrimit në karantinë, personi i parë që më vizitoi ishte Rexhep Mala i cili ishte, në atë kohë, i burgosuri i vetëm politik shqiptar në Foçë për faktin se Skender Kastrati dhe Agim Sylejmani ishin dënuar me izolim dhe ishin dërguar në burgjet e tjera të Bosnjës dhe Hercegovinës. Gjatë kohës së paraburgimit në Burgun e Qarkut në Sarajevë, një i dënuar që kishte ardhur në rigjykim nga Burgu i Foçës më tha se: "Në Foçë është një person i jashtëzakonshëm, edhe si njeri, edhe si i burgosur politik shqiptar e që ishte shembull për të gjithë të burgosurit e tjerë, Rexhep Mala".


Unë kisha lexuar shumë për burgje dhe kisha dëgjuar për shumë të burgosur politikë shqiptarë, mirëpo nuk kisha qenë më parë në burg, prandaj më mungonte ajo ana emocionale e përjetimit të burgut. Sa kam qëndruar në karantinë (afërsisht 40 ditë), Rexhep Mala më vizitonte disa herë në ditë për të më dhënë kurajë e që ishte me rëndësi të veçantë për një të burgosur, pa përvojë. Më vonë në burgun e Foçës u kthyen Skender Kastrati dhe Agim Sylejmani.

Që të tre ishin të jashtëzakonshëm në qëndrimet e tyre dhe vendosmërinë që edhe nga mjedisi i burgut të kontribuojnë në zhvillimet politike në Kosovë dhe hapësirat ku jetonin shqiptarët. Që të tre kishin kaluar në torturat më të rënda të mundshme, mirëpo në asnjë rast nuk i përmendnin ato për faktin se ishin të farkuar për çdo sakrificë që kërkohej nga ata. Rexhep Malën e kam parë vetëm një herë të "ligështohet", përkatësisht kur kuptoi për vrasjen e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës. Në Burgun e Foçës kishte pak të burgosur politikë; ishte kroati Nikolla Novaković, themelues i Partisë Fshatare Kroate, një farmacist që fliste rrjedhshëm nëntë gjuhë botërore dhe që përpiquej ta mësonte gjuhën shqipe ndonëse ishte mbi 76 vjeç. Para Luftës së Dytë Botërore thoshte se kishte

punuar si farmacist në Durrës dhe kishte mbajtur mend vetëm disa fjalë në gjuhën shqipe. Ishte aty edhe famullitari Jozo Zovko, i dënuar për faktin se në një pelegrinazh në Megjugorje, besimtarëve, disa dhjetëramijërave, u kishte mbajtur një fjalim politik.

Burgu në Mostar: Pas demonstratave të vitit 1981, një numër i të burgosurve politikë shqiptarë u transferuan në Foçë, në ndërkohë që Skender Kastratin, Rexhep Malën, Agim Sylejmanin dhe mua na dërguan në Burgun e Mostarit për të mos ushtruar ndikim të të burgosurit politikë që do të transferoheshin në Burgun e Foçës. Gjatë qëndrimit në Burgun e Mostarit, kishim kontakt me shumë të burgosur politikë kroatë që dënoheshin për kundërvajtje shkaku se këndonin këngë nacionaliste apo angazhoheshin për pavarësinë e Kroacisë. Në mesin e tyre ishte një ish-futbollist i Velezhit të Mostarit dhe reprezentacionit të Jugosllavisë, Jadranko Topiq dhe klerikë kroatë. Nacionalistët kroatë të Hercegovinës ishin patriotë të jashtëzakonshëm që u shquan në luftën atdhetare kroate e sidomos në mbrojtje të Dubrovnikut. Rasti i dytë kur e kam parë "të ligështuar" Rexhep Malën ishte data e 23 majit 1983 kur u lirua nga Burgu i Mostarit sepse aty mbetën në vuajtje të dënimit dy shokë të idealit, Skender Kastrati (me të cilin ishte në një grup që u dënuan) dhe Agim Sylejmani. Unë u lirova dy ditë pas Rexhep Malës, më 25 maj 1983. Rexhep Mala përhëndetej me shokë të idealit me: "mirë u pafshim në betejat e radhës, deri në çlirim dhe bashkim kombëtar...". Nuk kishte rrugë tjetër për Rexhep Malën sepse kuptimi i jetës së tij ishte lufta për liri dhe bashkim kombëtar. Për këtë qëllim kërkonte bashkëluftëtarë dhe bashkudhëtarë, mbrapa të cilëve kurrë nuk fshihej por gjithmonë ishte i pari në përballje me rrezikun. Ishte gueril i lindur dhe luftëtar i bindur. Me një trup muskuloz, me një mjekër si Çerçiz Topulli, i vëmendshëm deri në perfekcionim, vështirë se do të mund të kapej nga organet ndjekëse të Serbisë dhe Jugosllavisë. Rexhep Mala ka mundur të kapej vetëm në saje të gabimeve të të tjerëve apo mungesës së kujdesit për aktivitete ilegale nga të tjerët. Pas daljes nga burgu, Rexhep

Mala nuk e ka lëshuar Kosovën por se ka vepruar dhe mbijetuar në ilegalitet të thellë duke vepruar në hundën e armikut, në Prishtinë ku kanë qenë të përqendruar hetuesit më të shquar të policisë serbe dhe jugosllave dhe ku ishte formuar një ekip i veçantë për kapjen e Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës. Për aq sa e kam njohur Rexhep Malën, jam i sigurt se në asnjë rrethanë nuk do të binte i gjallë në duart e policisë apo UDB-së serbe dhe jugosllave.



Kosova pa dhe ne Rexhep Malën: Po të jetonte Rexhep Mala në Kosovën e sotit do të ndjehej shumë i dëshpëruar për faktin se kjo Kosovë, as si kornizë nuk i përmbush qëllimet e Rexhep Malës. Nuk do ta pranonte dhe nuk do të pajtohej me këtë gjendje. Nuk do të mund të mbijetonte si pjesë e këtij moçali politik ku antivlerat dhe ata që e kanë futur në burg Rexhep Malën po bëjnë politika për Kosovën. Them se është shumë më dinjitoze rënia heroike e Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës se jeta në këto kushte dhe në këto rrethana. Disa personalitete lindin, jetojnë, veprojnë dhe kalojnë në amshim sepse janë të përcaktuar ta përmbushin një mision historik, kombëtar dhe njerëzor. Për ta nuk është me rëndësi kohëzgjatja e jetës por me çka e përmbushin jetën e tyre. I tillë ishte Rexhep Mala. Ai nuk e pranonte lirinë e asaj kohe të shndërruar në robëri të jetueshme. Rexhep Mala nuk do të pajtohej as me këtë liri, që për dikë është bërë parajsë e grykësisë, do ta kundërshtonte me gjithë forcën sikur që nuk do të pranonte të jetonte me këta "gjarprinj të gjakut", pavarësisht nëse më parë i kishte shokë. Rexhep Mala e kishte zgjedhur vet rrugën e lirisë, rrugën e sakrificës për popullin dhe atdheun, jo se ia kishte imponuar dikush. Prandaj, jam i sigurt se Rexhep Mala, ndjehet


shumë më mirë në shoqëri me Nuhi Berishën, Fehmi dhe Xhevë Lladrovcin, Isa Kastratin, Agim Ramadanin, Sali Çekun, Ilaz Kodrën, Remzi Ademajn, Luan dhe Shkëlzen Haradinajn, Zahir Pajaziti, Afrim Zhitia, Bahri dhe Fahri Fazliu e sidomos me dy komandantët të cilëve do iu shërbente me besnikëri dhe përkushtim të plotë; me Bacën e Madh, Frymëzuesit dhe Sakrifikuësit për Liri, Pavarësi dhe Bashkim Kombëtar, Adem Demaçin dhe Komandantin Legjendar, Adem Jashari sikur me të gjithë heronjtë e kombit (ata të vërtet), dëshmorët e kombit dhe ushtarët e së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Rexhep Mala nuk do të duronte që shokët e idealit dhe të luftës t'i tërheqin zvarrë burgeve të Kosovës apo t'i degdisin nëpër burgjet e shteteve të huaja shkaku që nuk e duan muzikën politike dhe shoviniste sipas notave të Vuçiqit dhe Sheshelit sikur edhe disa grabitçarëve ndërkombëtarë!

Rexhep Mala, në rrugëtimin drejt qëllimeve që ia kishte vënë vetes, shkoi deri në fund, nuk u lig e as nuk u dorëzua duke ia dhënë Kombit dhe Atdheut krejt ate që pati mundësi t'ia jepte, jetën e vet. Rexhep Mala e kishte dhe e ka një grua të jashtëzakonshme, Hanifen që ishte dhe është pjesë e pandashme e jetës dhe amshimit të Rexhës. E ka Fitoren, që fare pak e përjetoj dashurinë e babait Xhepës për të cilin më shumë ka dëgjuar nga shokët e Rexhep. Edhe vëllai Hasani nuk iu nda kurrë në të gjitha përpjekjet e Rexhep.

Rexhep Mala e bëri ate që kërkohej nga ai dhe nga çdo shqiptar që i ka borxh Kombit dhe Atdheut, lirinë dhe bashkimin kombëtar. Po ne që krenohemi se kemi qenë në burg me Rexhepin, që kemi qenë shokë të Rexhep, ç'kemi bërë për ta arsyetuar kujtimin për veprën, jetën dhe sakrificën e Rexhep. Disa kemi bërë shumë pak, disa të tjerë të kundërtën që e ka bërë Rexhep Mala duke u ndalur në fillim të rrugës.

Lavdia iu takon atyre që krijojnë vepra, turpi iu takon atyre që duan të përfitojnë nga vepra e të tjerëve! Në Medaljonin e Lavdisë, ana e Artë dhe e ndritshme e lavdisë është e tyre që krijuan vepra, ndërsa ana e flakëruar e që i ka rënë shkëlqimi, deri në ndryshkje, jemi ne të cilët u ndalëm në gjysmë të rrugës apo u dorëzuam para lakmisë së parë, të postit apo asaj materiale!

Joe Bideni, mik i madh i shqiptarëve



Jahja LLUKA

Javën që lamë pas Joe Biden u certifikua si president i ShBA-së. Bidenit ia certifikuan 306 vota elektorale, karshi 232 sa i kishte presidenti i deritashëm Donald Trump. Për ne, shqiptarët, fitorja e mikut të madh Biden është e një rëndësie të veçantë, sepse askush më mirë se ai nuk na njeh.

Lufta e shqiptarëve për liri dhe pavarësi u mbështet fuqishëm nga Bideni. Për herë të parë ai e vizitoi Kosovën më 1997. Por, para kësaj, më 1991, ishte në Beograd ku ka takuar Shlllobodan Millosheviqin.

Për këtë takim, Bideni është shprehur kështu: "Në vizitën time të parë në Serbi, ku kisha një takim të gjatë me Millosheviqin, kur ai më pyeti se çfarë mendoj për të, i thashë: Zotëri president, mendoj se jeni kriminel lute dhe se duhet të trajtoheni si i tillë". Si senator, Biden kohë kërkonte nisjen e negociatave, që Kosovës t'i rikthehej autonomia e humbur. Por, masakrat dhe gjenocidi serb ndaj shqiptarëve në luftën e fundit, bënë që Biden, bashkë me vendimmarrësit tjerë amerikan, të jetë ndër vendimtarët që nisën rezolutën që i lejonte presidentit amerikan të niste sulmet mbi caqet

policore dhe ushtarake serbe. Më 24 mars 1999 nisën sulmet e NATO-s që do t'ia sjellin Kosovës lirinë.

Një vit pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, më 21 maj 2009, Joe Biden, në cilësinë e zëvendës-presidentit të ShBA-së, vjen për vizitë zyrtare në Kosovë. Atëherë e kishte një

porosi të fuqishme për shqiptarët, se pavarësia e Kosovës ishte e pakthyeshme. Me 16 gusht 2016 vjen përsëri në Kosovë. Një ditë pas arritjes, bashkë me familjen e tij merr pjesë në inaugurimin e rrugës që mban emrin e djalit të ndjerë, Beau Biden, i cili kishte ndërruar jetë me 6 janar të vitit

2015. Beau Biden kishte punuar në Kosovë, pas luftës, duke ndihmuar në trajnimin e prokurorëve dhe të gjykatësve vendas.

Gjatë fushatës së tij, Bideni shpali një program për Kosovën dhe bisedimet e saj me Serbinë, duke e rikthyer edhe njëherë sytë e Amerikës kah

Ballkani.

Mikut tonë Joe Biden i urojmë fitoren, duke i dëshiruar mandat të suksesshëm.

Në Kanun thuhet se shtëpia është e mikut dhe Zotit. Andaj, Joe Biden do të kujtohet përherë si një mik i madh i shqiptarëve që ka ndihmuar në kauzën tonë për liri, për paqe e për pavarësi.



Nën hisen e diellit që na takon



Shkruan: Musli KRASNIQI

10 janar 1921. Ekspedita famëkeqe e ushtrisë dhe xhandarmërisë mbretërore serbe po hynte ndarazi në Prapashticë dhe Keçekollë, pasi kishte lënë shumë të masakruar në Sharban dhe kishte plaçkitur shtëpi të tëra në Koliq.

Gallapi (Gollaku), si dhe vise të tjera të Kosovës, asokohe ishte shndërruar në vatër të rezistencës e të kryengritjes kundër pushtuesit serbo-malazez, që nuk po i prante vrasjet dhe masakrat kundër shqiptarëve që nga viti 1912 e këtej.

Çeta të shumta luftëtarësh

shqiptarë, për shkak edhe të konfiguracionit të përshtatshëm gjeografik, vepronin në fshatra të thella të këtij rajoni, duke e mbajtur gjallë frymën e luftës për liri dhe duke shtruar terrenin për kryengritje të përgjithshme. Në dijeni të veprimtarisë së çetave të luftëtarëve shqiptarë në viset e Gallapit e të Llapit, që në atë kohë njihej si Lëvizja Kaçake, qeveria serbe kishte shfrytëzuar borën dhe acarin e madh të janarit të vitit 1921, për të nisur ekspeditën kundër këtij rajoni, duke i çuar buzë shfarosjes sidomos Keçekollën dhe Prapashticën.

Mbi 2 mijë civilë shqiptarë, kryesisht banorë të këtyre dy fshatrave, fillimisht burra, e më pas fëmijë, gra e pleq, kaluan nëpër plumbat dhe bajonetat e ushtarëve, xhandarëve, paramilitarëve e kolonëve serbë e malazezë.

Me zjarr e me hekur, ekspedita serbe shkrumbi e shfarosi

gjithçka që i pa syri.

Ishte kjo një nga krimet më të tmerrshme dhe më të pashembullta të kohës, në përmasa të gjenocidit, që kalonte kufijtë e imagjinatës.

Operacioni ushtarak përfundoi tek pas katër ditësh, pasi nuk la asnjë frymë në këto fshatra dhe nuk arriti të shtrihet më tej, pasi hasi në rezistencën e luftëtarëve shqiptarë, të cilët, të gjendur larg, nuk kishin arritur të viheshin me kohë në mbrojtje të banorëve të Prapashticës e të Keçekollës.

Nëpërmjet veprimtarit Nazim Gafurri dhe Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, kësaj ngjarjeje makabre iu dha jehonë në shtypin vendor dhe ndërkombëtar të kohës, por edhe në qeveritë dhe parlamentet e shteteve të ndryshme evropiane.

Gjysmë shekulli më pas, brigjeve

të Gallapit po e rriste shtatin një djalosh, që më vonë historia do ta njoh si një nga guerilët dhe komandantët më të shquar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Si fëmijë, nëpër oda burrash dhe si nxënës, nëpër libra të ndaluar të historisë, ai po njihej me të bëmat kundër popullit të tij ndër shekuj, në Keçekollë e në Prapashticë, në Gallap e në Llap, në Kosovë e në viset e tjera etnike.

Krahas shtatit, dita-ditës brenda tij po rritej edhe urrejtja kundër pushtuesit dhe dëshira për hakmarrje. Tanimë, i brumosur me virtutet e luftëtarit çlirimtar, Zahir Pajaziti, me pushkën krahut, po e vazhdonte aty ku e kishin lënë kryengritësit e mëparshëm. I betuar se pa rënë ai, nuk do të bjerë Kosova, furtunës do t'ia kthente gjoksin dhe asnjëherë shpinën, ndërsa atdheut të tij do t'ia rriste lavdinë dhe madhësinë.

Atë që Zahir Pajaziti do ta linte në

janar të '97-s, do ta finalizonin shokët e tij, Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe i tërë populli i Kosovës, dy vite më vonë.

Fatkeqësisht, Prapashtica, Keçekolla, Gallapi dhe e tërë Kosova, para lirisë, po përballeshin edhe njëherë herë me dhunën, gjakimin dhe zjarrin e hasmit shekullor.

Por fundi i hasmit ishte parashikuar profetikisht nga urtësia e Anton Çettës, në analogji të vjehrrës së djegur së bashku me shtëpinë, pasi kishte dhunuar në vazhdimësi nusen: 'E dija që do ta hajë dreqi, por se do ta hajë të pjekur, s'ma merre mendja'.

Në këtë 100-vjetor të masakrës së Keçekollës e të Prapashticës, Gallapi kujton me pietet martirët dhe heronjtë e vet të të gjitha etapave, tani, i lirë, nën hisen e diellit që i takon.



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Khudistet rrëmbejnë tri medalje në Katar



Khudistet Distria Krasniqi, Majlinda Kelmendi dhe Nora Gjakova ia kanë sjellë Kosovës tri medalje nga Mastersi i mbajtur në Doha të Katarit. Krasniqi është stolitur me medaljen e artë, kurse Kelmendi dhe Gjakova me të bronzën

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 JANAR - Khudistet e Kosovës kanë shkëlqyer të hënën në Mastersin e mbajtur në Doha të Katarit, pasi kanë rrëmbyer dy medalje: të artën dhe të argjendtën. Performanca e Distria Krasniqit ka qenë në nivel të lartë, pasi pejania mposhti të gjitha kundërshtarët dhe në fund ka rrëmbyer medaljen e artë.

Krasniqi ka konfirmuar se aktualisht është khudistja më e mirë në botë në kategorinë deri 48 kilogramë. Distria raundin e parë e kaloi pa luftë, kurse në raundin e dytë e mposhti me "Ippon" sllovenen Marusa Stangar. Khudistja Krasniqi në çerekfinale e mposhti portugezen Catarina Costa me një waza-ari, kurse në gjysmëfinale e mposhti francezen Melanie Clement me ippon pas 3:01 minuta luftë.

Në finale Distria triumfoi kundër garueses nga Japonia, Funa Tonaki. Për paraqitjen e khudistes nga Peja

ka shkruar edhe IJF-ja: "Një paraqitje dominuese nga Distria Krasniqi e Kosovës, duke e hedhur për dy shënime brilante, ish-kampionen e botës Tonaki. Është titulli i tretë në Masters për Krasniqin".

Kampionia olimpikë, Majlinda Kelmendi, e fitoi medaljen e bronzë. Në luftë për këtë medalje në kategorinë deri 52 kg, Kelmendi e mposhti belgen Charline Van Snick. Ajo mposhti

rumunen Andreea Chitu, polaken Agata Perenc dhe zviceranen Evelyne Tschopp. Në gjysmëfinale pësoi humbje nga francezja Amandine Buchard, por Majlinda u kthye në luftë për vend të tretë duke mposhtur belgen Van Snick. Edhe khudistja Nora Gjakova e ka fituar medaljen e bronzë në kategorinë deri 57 kilogramë, në Mastersin në Doha të Katarit. Ajo në finale e mposhti portugezen me përvojë Telma Monteiro.



SHKURT

Traylor, MVP i xhiros 14

Në fundjavë u zhvillua xhironja e 14-të në Prince Caffè Superligën e Kosovës në basketboll, apo e fundit për stinorin vjeshtor. Derbin e xhiros e fitoi Rahoveci që mundi Golden Eagle Yllin 92:86, ku u dallua Isaiah Traylor. Basketbollisti amerikan shënoi 32 pikë në këtë ndeshje, derisa kishte edhe dhjetë kërcime e dy asistime, me një indeks prej 28. Përveç lojës së mirë, ai u faulua edhe 12 herë në këtë përballje, derisa dëshmoi lojë të mirë në çastet vendimtare. Rahoveci përfundoi stinorin vjeshtor në vendin e parë me 11 fitore dhe tri humbje, derisa njëri nga më meritoret është Isaiah Traylor. Ndërkohë, top pesë basketbollistët me indeksin më të lartë në këtë xhiro ishin: Demetris Morant (40) i Golden Eagle Yllit, Brandon Walters (36) i Pejës, Isaiah Traylor (28) i Rahovecit, Xavier Cannefax dhe Joshua Martin (26) të Ponte Prizrenit.

Plaku i bashkohet Teutës

Sulmuesi veteran i Kategorisë Superiore, Sebino Plaku, do të luajë për Teutën këtë sezon. 35-vjeçari u prezantua të hënën në ambientet e klubit durrsak nga shefi i klubit Enid Furxhiu. Transferimi i Plakut nga Kastrioti te Teuta ishte paralajmëruar prej disa ditësh. Ish-sulmuesi i Tiranës, Dinamos, Partizanit, Flamurtarit e shumë ekipeve të tjera zëvendëson Rubin Hebajn në klubin durrsak.

Gattuso: Rrahmani do t'i ketë sërish shanset e tij

Napoli të dielën e mposhti Udinesen (1-2), por protagonist në këtë sfidë ishte kapiteni i Përfaqësues së Kosovës, Amir Rrahmani. Gattuso e zëvendësoi mbrojtësin "dardan" me të filluar pjesa e dytë, por në një intervistë ka thënë se Rrahmani do t'i ketë përsëri mundësitë e tij. "Më vjen keq për Amirin. Ai është një profesionist i shkëlqyeshëm, por trajneri duhet t'i bëjë zgjedhjet e tij. Ai do të ketë akoma shanset e tij, por kësaj radhe vendosa ta heq në gjysmën e ndeshjes", ka thënë Gattuso.

Marseille interesohet për Hysajn

Mbrojtësi i Kombëtares shqiptare, Elseid Hysajn, është afër largimit nga Napoli pas pakënaqësive që ka pasur në klubin italian. Kontrata e mbrojtësit "kuqezi" skadon në fund të edicionit me Hysajn që nuk ka pranuar ta vazhdojë kontratën me napolitanët. Sipas raportimeve të "L'Equipe", klubi francez i Marseilles ka shprehur interesim për Hysajn. 26-vjeçari është pjesë e Napolit që nga viti 2015 kur u transferua nga Empoli.

Prishtina - Drita, kryendeshja në garën e Kupës

PRISHTINË, 11 JANAR - Në ambientet e stadiumit "Fadil Vokrri" në Prishtinë të hënën në praninë e Komisionit të Garave dhe përfaqësuesve të klubeve

është bërë tërheqja e shortit për 1/8 e finales së Kupës së Kosovës. Fati deshi që në këtë fazë të ketë përballje shumë të forta, ku pa dyshim veçohen

ndeshjet Prishtina - Drita dhe Llapi - Ballkani. Ndeshjet e këtij rrethi do të zhvillohen më 10 shkurt. Çiftet e 1/8 së finales: A&N - Flamurtari, Llapi -

Ballkani, Trepça '89 - Ferizaj, Drenica - Ulpiana, Dukagjini - 2 Korriku, Istogu - Gjilani, Prishtina - Drita, Arbëria - Feronikeli.



Fillon afati kalimtar në basketboll

PRISHTINË, 11 JANAR - Të hënën ka filluar afati kalimtar për basketbollistë/e. Afati kalimtar do të përfundojë të premten më 15 janar. Në këtë afat klubet mund t'i regjistrojnë lojtarët vendorë apo edhe të huaj. Për

basketbollistët vendorë, afati përfundon të premten, kurse lojtarët e huaj mund të regjistrohen deri 72 orë para xhiros së 22-të në Prince Caffë Superligë. Basketbollistët vendorë pas paraqitjes së

dokumente mund të luajnë në xhiron e 15-të në elitë, që zhvillohet në fundjavë. Afati kalimtar pritet të jetë mjaft interesant, pasi skuadrat kanë paralajmëruar disa përfundime me lojtarë vendorë, por edhe të

huaj, duke e bërë më interesante Superligën e Kosovës, por edhe garat e tjera, si Superligën e Femrave apo edhe Ligën e Parë të Meshkujve, ku klubet janë mjaft aktive për t'i arritur synimet që kanë.



Ballkani largon gjashtë futbollistë, tre i huazon

SUHAREKË, 11 JANAR - Skuadra e Ballkanit me anë të një njoftimi zyrtar në faqen e vet në "Facebook" ka bërë me dije se deri tash ka larguar gjashtë futbollistë. Sulmuesi anësor Liridon Fetahaj dhe portieri Armend Rugji janë në mesin e atyre që janë larguar nga skuadra që në pranverë do të drejtohet nga Bledi Shkëmbi. "Pas mbarimit të stinorit vjeshtor, tani në afatin kalimtar i cili karakterizohet me lëvizje të futbollistëve, duke u përpjekur për më të mirën e klubit dhe lojtarëve kemi arritur marrëveshje të dyanshme dhe me mirëkuptim për ndërprerjen e bashkëpunimit me lojtarët: Armend Rugji, Liridon Fetahaj, Roni Gashi, Melos Bajrami, Armin Bosnjak, Leorant Marmullaku. Ne si klub i falënderojmë të gjithë të



lartcekurit për kontributin e dhënë duke mbrojtur ngjyrat e klubit tonë", thuhet në njoftimin e Ballkanit. Skuadra nga Suhareka ka njoftuar se ka gjetur bashkëpunim me klubit nga Liga e Parë për huazimin e

lojtarëve të cilët nuk kanë pasur shumë hapësirë në klub. Futbollistët e huazuar janë Albin Berisha (Liria FC), Endrit Asllanaj (FC Malisheva) dhe Bleon Sekiraqa (FC Malisheva).

Lakersat sigurojnë fitoren e tetë, Golden State mezi e mposhti Toronton

HOUSTON, 11 JANAR - Kampioni në fuqi i NBA-s, Los Angeles Lakers, vazhdon formën e mirë, teksa ka regjistruar edhe fitoren e tetë sezonale, në 11 ndeshje të zhvilluara deri tani. Viktima e radhës e Lakersave ishte Houston Rocketsi, që u dorëzua në shtëpi me rezultatin 102-120. Në "Toyota Center" të Houstonit ishin kalifornianët që e nisën vrullshëm ndeshjen dhe pas gjysmës së parë të ndeshjes, thujse kishin hipotekuar fitoren. Vendasit bënë diçka vetëm në fraksionin e tretë, por në fund nuk ia dolën ta shmangin humbjen. Anthony Davies ishte protagonist absolut për Los Angeles Lakersin me 27 pikë, 4 rikuperime dhe një asistim, ndërsa James Hardeni ishte në një natë të errët, pasi nuk arriti të shkojë përtej 20 pikëve të realizuara, raporton "ss". Vijon të bëjë mirë këtë sezon edhe Golden State Warriorsi, që arriti të fitojë ndaj Toronto Raptorit me rezultatin e ngushtë 106-105. Në "Chase Center" të San Franciscos, vendasit bënë gjithçka mirë deri në fund të fraksionit të tretë, por lëshuan në pjesën e fundit dhe për pak u rrëshqiti fitorja nga duart. Stephen Curry nuk ishte në një ditë të mirë, pasi shënoi vetëm



11 pikë, ndërsa më i miri i ndeshjes ishte kamerunasi Patrick Siakam me 25 pikë të shënuara, 11 rikuperime dhe 3 asistime, por që nuk u shërbyen kanadezëve të Torontos për ta shmangur humbjen. Forma e mirë e Kevin Durantit nuk po i shërben aspak Brooklyn Netsit, që pësoi humbjen e dytë radhazi dhe të 6-n sezonale, këtë herë në "Barclays Center" në shtëpi ndaj Oklahoma City Thunderit. 32-vjeçari Durant u shpall më i

miri i ndeshjes me 36 pikë, 11 topa të rikuperuar dhe 4 asistime, ndërsa për miqtë nga Ocklahoma, spikati kanadezi Shai Gilgeus-Alexander, që shënoi 31 pikë, rikuperoi 6 topa dhe dha 7 asistime. Në sfidat e tjera, Denver Nuggets triumfoi me rezultatin 89-114 ndaj New York Knicksit, i udhëhequr nga një formë e mirë e serbit Jokiç, ndërsa Minnesota Timberwolves mposhti me rezultatin 96-88 San Antonio Spursin.

SHKURT

Gjyqtari spanjoll infektohet me Covid

Gjyqtari i njohur spanjoll Antonio Mateu Lahoz ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Lajmi është publikuar në mediat iberike, në të cilat bëhet me dije se 43-vjeçari nuk ka shfaqur simptoma dhe po qëndron në izolim, ku i duhet të qëndrojë larg detyrës derisa të rikuperohet. Lahoz konsiderohet gjyqtari më i mirë i Spanjës. Ai ka debutuar në La Liga në vitin 2008, ndërsa në vitin 2011 ka marrë dhe stemën e FIFA-s. Gjithashtu, ai ka arbitruar në të gjitha nivelet ndërkombëtare të futbollit.

Casillas: Donnarumma duhet të largohet nga Milani

Gianluigi Donnarumma është një nga portierët më premtues të momentit dhe shumë specialistë të futbollit e konsiderojnë më të mirin në Serinë A. Me pritjet e tij ka dhënë kontribut për ecurinë fantastike të Milanit, megjithëse e ardhmja e tij me ngjyrat kuqezi mbetet ende e paqartë. Ish-portieri spanjoll Iker Casillas e ka këshilluar Donnarumma përmes faqes së tij zyrtare në "Twitter", që të largohet nga Milani. "Për mendimin tim, Donnarumma duhet të luajë për një klub me më tepër tradita. Gabimi im. Milani ka traditë. E kam fjalën për më tepër arritje në Evropë për momentin", ka shkruar Casillas.

Simeone: Jemi afër marrëveshjes me Dembelen

Trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, ka konfirmuar se ekipi i tij është shumë afër transferimit të sulmuesit Moussa Dembele. Sulmuesi i Lyonit pritet t'i bashkohet Atletico në formë huazimi, kurse ekipi spanjoll në fund të sezonit do të shfrytëzojë të drejtën e blerjes së kartonit të tij. Dembele tek Atletico do të zëvendësojë Diego Costan e larguar. "Mund të them se jemi në negociata të avancuara dhe besoj se shumë shpejt do të mbyllet kjo çështje", ka thënë Simeone. Dembele 24-vjeçar, këtë edicion ka shënuar një gol në 16 ndeshje, kurse me Lyonin ka kontratë deri në vitin 2023.

Leipzig nuk lejon largimin e Upamecanos

Pavarësisht prej interesimit nga e gjithë Evropa, mbrojtësi francez Dayot Upamecano do të qëndrojë në Leipzig të paktën deri në verë. Sipas gazetarit italian Fabrizio Romano, RB Leipzig nuk janë të hapur për ta shitur yllin e tyre, vlera e të cilit kap shifrën e 42 milionë euro. Ai pritet të largohet në verë por, sipas italianit, Upamecano do të qëndrojë në klub në janar dhe nuk do të shkojë gjëkund. Së fundmi, u raportua se edhe skuadra angleze, Chelsea, i ka hyrë garës për ta bindur mbrojtësin francez dhe ishin të gatshëm ta paguanë klauzolën e tij prej 42 milionë eurosh.

53-vjeçari japonez rinovon sërish me Yokohaman

Në shkurt feston 54-vjetorin e lindjes, por nuk ka ndërmend të tërhiqet nga futbollit. Fjala është për Kazuyoshi Miura, legjendën e futbollit japonez. Sulmuesi vijon të vendosë rekorde të pabesueshme, teksa është pjesë e Yokohama FC prej dhjetorit të vitit 2005. "Veterani" i repartit ofensiv do të vazhdojë të luajë me ekipin e elitës së futbollit japonez. Me anë të një postimi në "Twitter", Yokohama FC lajmëron zgjatjen e bashkëpunimit me një tjetër vit me sulmuesin e njohur. Kazuyoshi Miura (55 gola me kombëtaren e Japonisë), i cili njihet si futbollisti më i moshuar në nivel profesionist, do të jetë pjesë e ekipit kryeqytetas edhe sezonin e ardhshëm. "Pasioni im për futbollin vetëm sa rritet. Do të luaj më shumë ndeshje sezonin e ri, jam gati të ndihmoj skuadrën për të fituar", u shpreh Miura pas rinovimit të kontratës.



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Prishtina, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Ndërmarrja Hidroekonomike,,Ibër-Lepenc''SH.A. –Prishtinë, publikon këtë:

KONKURS**1. Inxhinier i Gjeodezisë dhe i Sistemit Gjeografik të Informimit (S.G.J.I.) (1)****Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:**

- Kryen të gjitha punët gjeodezike për objektet ndërtimore, rrjetin nëntokësorë dhe mbitorësorë etj.;
- Bashkëpunon me Drejtoratet Komunale për Gjeodezi dhe Kadastër si dhe Agjencionin Katastral të Kosovës;
- Ndërmerr veprime të nevojshme për ruajtjen e pronës;
- Krijon dhe ruan dokumentacionin gjeodezik;
- Kryen edhe punë tjera, të kërkuara nga eprori, të cilat i përgjigjet pregatitjes së tij profesionale dhe aftësive të fituara me punë, të cilat kanë të bëjnë me natyrën e punëve të këtij vendi të punës;
- Për punën e vet i raporton dhe përgjigjet eprorit të drejtpërdrejt dhe Drejtorit të Administratës

Kushtet:

- Përgatitja Superiore (Fakulteti i Gjeodezisë);
- Njohja e programeve kompjuterike
- Përvojë pune në profesion se paku 3 (tri) vite.

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .**2. Inxhinier i Bujqësisë në Nj.Punuese "Vushtrri" (1)****Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:**

- Harton planin e shfrytëzimit e sistemit për ujitje dhe kullim, në bazë të dhënave të grumbulluara nga plani vjetor;
- Përkujdeset për realizimin e planit për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes;
- Merr pjesë në organizimin – koordinimin dhe kontrollimin e punës në shfrytëzimin e sistemit për ujitje dhe kullim në kuadër të njësive punuese;
- Raporton realizimin e planit periodik dhe vjetor udhëheqësit të njësive punuese;
- Bashkëpunon dhe i koordinon punët me teknikët e njësive punuese;
- Punon dhe punë të tjera që i përgjigjet kualifikimit të tij;
- Për punën e vet i përgjigjet udhëheqësit të njësive punuese "Vushtrri" dhe Menaxherit të Nj. A. "Ujitja".

Kushtet:

- Përgatitja Superiore (Fakulteti i Bujqësisë);
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moralë të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;
- Njohuri e programeve kompjuterike;
- Përvoja e punës 2 (dy) vite.

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .**3. Zyrtar ligjor (1)****Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:**

- Kryen të gjitha punët juridiko-administrative që kanë të bëjnë me ruajtjen e pronës, vlerësimin e dëmeve të shkaktuara të palëve, përgatitjen e ofertave dhe marveshjeve të kompenzimit të dëmshëm etj.;
- Bashkëpunon me Drejtoratet Komunale për qështje juridiko pronësore;
- Bashkëpunon me Drejtoratet Komunale për qështje të inspektionit, me qëllim të ruajtjes përkatësisht liritimit pronës së ndërmarrjes.
- Përfaqëson në gjykata etj.
- Kryen edhe punë tjera të kërkuara nga eprori, të cilat i përgjigjet përgatitjes profesionale dhe aftësive të fituara me punë, të cilat kanë të bëjnë me natyrën e punëve të këtij vendi të punës;
- Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjet shefit të shërbimit dhe Drejtorit.

Kushtet:

- Fakulteti Juridik;
- Përvoja e punës dy (2) vite;
- Njohja e programeve kompjuterike;

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .**4. Asistent/e Administrativ/e i/e Kryeshefit Ekzekutiv (1)****Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:**

- Pranon dokumentacione të ndryshme dhe e bën shpërndarjen;
- Pranon thirrje telefonike;
- Kujdeset për furnizim me kohë me material shpenzues;
- Mban evidencën e shpenzimeve të kabinetit të KE;
- Kujdeset për përgatitjen me kohë të materialeve;
- Kujdeset për mirëmbajtjen përkatësisht kushtet higjieniko-teknike të zyrës;
- Kujdeset për aranzhimin e sallës për mbajtjen e mbledhjeve të KE;
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv

Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore;
- Njohuri e programeve kompjuterike;
- Përvoja e punës 1 (një) vit;

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .**5. Asistent/e i/e Drejtorit Teknik (1)****Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:**

- Pranon dokumentacione të ndryshme dhe e bën shpërndarjen;
- Pranon thirrje telefonike;
- Kujdeset për furnizim me kohë me material shpenzues;
- Mban evidencën e shpenzimeve të Drejtorit Teknik;
- Kujdeset për përgatitjen me kohë të materialeve;
- Kujdeset për mirëmbajtjen përkatësisht kushtet higjieniko-teknike të zyrës;
- Për punën e saj i përgjigjet Drejtorit Teknik

Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore;
- Njohuri e programeve kompjuterike;
- Përvojë pune 1 (një) vit;

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .**6. Asistente në Njësive Punuese "Shkabaj"(1)****Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:**

- Është përgjegjës për pranimin e palëve në Njësive Punuese "Shkabaj"
- Pranon postën dhe bën shpërndarjen e të njëjtës;
- Mban evidencën dhe përkujtuesin e punëve dhe takimeve;
- Pranon thirrje telefonike;
- Kujdeset për furnizim me kohë me material shpenzues;
- Mban evidencën e shpenzimeve të Njësive Punuese;
- Kujdeset për përgatitjen me kohë të materialeve si hartimi, përkthimi,
- shumëzimi, arkivimi, shpërndarja etj.;
- Kujdeset për mirëmbajtjen përkatësisht kushtet higjieniko-teknike të zyrës;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së Udhëheqësit të Njësive Punuese, të cilat për nga natyra i përkasin këtyre detyrave të punës;
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Nj.Punuese.

Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore ;
- Përvoja e punës një (1) vit;
- Njohja e programeve kompjuterike.

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .**7. Teknik për mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike të ndërmarrjes (1)****Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:**

- Kujdeset për mirëmbajtjen e nxehtjes qendrore
- Ben riparimin e pajisjeve të nevojshme
- Ben instalimet mbi sipërfaqet e murit;
- Ben mirëmbajtjen e elementeve të instalimit;
- Parashikon nevojat për pjesë rezervë për nevojat e mirëmbajtjes së objektit;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së Shefit të logjistikës, të cilat për nga natyra i përkasin këtyre detyrave të punës;
- Për punën e tij i përgjigjet Shefit të logjistikës dhe Drejtorit të Administratës.

Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore (Dega elektroteknikë);

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .**8. Referent i dokumentacionit teknik të objekteve (1)****Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:**

- Arkivon, klasifikon dhe ruan dokumentacionin teknik;
- Rregullon dhe ruan dokumentacionin sipas përmbajtjeve karakteristike;
- Mban regjistrat adekuat të dokumentacionit;
- Merr pjesë në hartimin e dokumentacionit teknik të ri;
- Kryen edhe punë tjera, të cilat i përgjigjet përgatitjes shkollore dhe aftësive të fituara në punë;
- Për punën e vet e raporton dhe përgjigjet Shefit të Shërbimit dhe Menaxherit të Nj.Afariste "Uji dhe Gjenerimi".

Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore (Dega e Ndërtimitarisë);
- Njohuri e programeve kompjuterike;
- Përvojë pune në profesion prej së paku 1 (një) vit.

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .**9. Elektromonter (1)****Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:**

- Kujdeset për mirëmbajtjen dhe operimin e pajisjeve elektro-energjetike në tërë hidrosistemin teknike siq janë:
- LP 10 kV, LP 35 kV, e që të dy llojet e largëpërquesve i kemi më gjatësi traseje rreth 120km,si dhe lartësi të shtyllave deri në 24m.
- Rrjetin 0.4 kV për tërë hidrosistemin.
- Transformator me kapacitete nga 50 kVA e deri 6.3 MVA.
- Trafokthina dhe ndërprera 35kV
- Rele multifunksionale nëpër trafokthina 35kV, 10kV
- Transformator rrymor dhe të tensionit nëpër Stacione pompike.
- Realizon urdhrat për evitimin e prishjeve, operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike,
- Merr pjesë në riparime dhe i zbaton planet e riparimit;
- Është në kontakt të përhershëm me shefin, apo me inxhinierin përgjegjës;
- Paraqet me kohë kërkesat për furnizim me material të nevojshëm si dhe me pjesë reserve,
- E njofton me kohë udhëheqësin e drejtpërdrejt mbi gjendjen e pajisjeve elektrike në hidrosistem,
- Punon në specifikimin e punimeve për tenderime për punët në kuadër të shërbimit të elektromakinërisë,
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrat të udhëheqësit të drejtpërdrejt, në kuadër të profesionit dhe aftësive të tij;
- Për punën e vet i përgjigjet dhe i raporton shefit të shërbimit të elektro-makinërisë dhe inxhinierit perkates.

Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore, punëtor me kualifikim të lartë (dega elektro-energjetikë)
- Përvoja profesionale 5 (pesë) vite
- Duhet të jetë i aftë për punë në lartësi dhe në nivel tensioni deri në 35kV

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .**10. Drejtuesi i Automjetit (1)****Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:**

- Drejton automjetin;
- Kujdeset mbi rregullsinë dhe mirëmbajtjen e rregullt vijuese të automjetit;
- E mban evidencën e shpenzimeve të karburantit, lubrifikimit të vajit dhe materialit tjetër;
- E mban evidencën e orëve të punës së automjetit;
- E kontrollon gjendjen e automjetit;
- I evidenton defektet e vogla dhe bën ndërrimin e disa pjesëve;
- Mban evidencën mbi qarkullimin dhe shfrytëzimin e automjetit, kontrollin preventiv dhe riparimin, harxhimin e gomave, skadimin e regjistrimit etj.;
- I arsyeton shpenzimet për karburante;
- Kur automjeti gjendet në riparim në punëtori, i ndihmon mekanikut gjatë intervenimit;
- Kryen edhe punë tjera të kërkuara nga KE ose menaxheri i zyrës;
- Për punën e tij i përgjigjet Shefit të Logjistikës dhe Drejtorit Administratës.

Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore;
- Profesionalist i kualifikuar për drejtimin e automjetit të udhëtarëve;
- Përvojë pune në profesion së paku 3 vite.

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .

11. Operues në SP “Gjurashin” (1)**Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:**

- Operon me stabilimentet e S.P dhe kryen të gjitha punët instaluese, mekanike dhe agjystatorisë në S.P;
- Bën mirëmbajtjen e stabilimenteve të pompave, merr pjesë në riparim dhe i zbaton masat teknike të mbrojtjes në punë;
- E mban ditarin mbi punën e stacioneve pompake dhe paraqet me kohë gjendjen dhe nevojat për furnizimin e mjeteve dhe veglave rezervë;
- I përmbahet udhëzimeve teknike për punë të drejtë të stabilimenteve në S.P;
- Është përgjegjës për sigurimin fizik të objekteve dhe të stabilimenteve në kuadër të S.P;
- Sipas nevojës punon edhe në S.P tjera në kuadër të Ndërmarrjes;
- Kryen punët tjera të cilat ia përcakton udhëheqësi i drejtpërdrejtë;
- U përmbahet udhëzimeve teknike të shërbimit për mirëmbajtjen e elektromakinerike të

Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore (Dega e makinerisë ose elektros).

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .

12. Sektor në Nj.Punuese “Ujman” (1)**Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:**

- Kryen të gjitha punët e elektricitetit që punon me ndërtime, gjatë ndërrimit e koordinon punën e tij me turbinistin;
- Përgatitë dhe drejton makinën sipas procesit teknologjik deri tek sinkronizimi;
- Gjatë ndërrimit e përcjell punën e makinës dhe të pajisjeve tjera;
- Bën kontrollin dhe leximin e të gjitha njësive elektrike, të temperaturës dhe të njëjtat i mirëmban dhe intervenon sipas nevojës;
- Merr pjesë në riparimin, i zbaton masat MHT në punë;
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të inxhinierit të prodhimit për punë të elektros dhe udhëheqësit të NJP;
- Për punën e tij i përgjigjet inxhinierit të prodhimit për punë të elektros dhe udhëheqësit të NJ.P.

Kushtet:

- Punëtor me kualifikim të lartë (Dega elektro-energetike),
- Provimi profesional;
- Përvojë pune në profesion 3 (tri) vite.

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .

13. Punëtor për mirëmbajtjen e kanalit në Nj.Punuese “Ujman”(1)**Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si në vijim**

- Punon në mirëmbajtjen, ruajtjen dhe pastrimin e kanalit dhe objekteve në kanal (pastrimi i grilave, bankinave, mirëmbajtja e rrugëve përgjatë kanalit si dhe punë tjera që i jep udhëheqësi i tij) ;
- Kujdeset për ruajtjen e pajisjeve dhe materialit ndërtimor ;
- Viziton objektet në trase për të cilën është i ngarkuar dhe pengon tjetërsimin e pronës dhe pasurisë ;
- Për çdo tentim të uzurpimit të pronës ose keqpërdorimit e saj, e njofton eprorin e drejtpërdrejt ;
- Për çdo avari elementare apo të shkakuar qëllimisht njofton udhëheqësin e drejtpërdrejtë ;
- Kryen edhe punë tjera, të cilat i përgjigjen përgatitjes shkollore dhe aftësive të fituara në punë;
- Për punën e tij i raporton dhe përgjigjet teknikut dhe shefit.

Kushtet:

- Punëtor i kualifikuar (Dega e Ndërtimitarisë), ose përgatitja e ulët shkollore;

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .

14. Punëtor në mirëmbajtjen e rrjetit të sistemit të ujitjes në Nj.Punuese “Vushtrri” (5)**Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si në vijim:**

- Kryen të gjitha punët për mirëmbajtjen e objekteve për ujitje dhe kullim;
- Viziton objektet dhe varësisht nga nevoja intervenon në evitimin e defekteve;
- Punon në sanimin e pjesëve të dëmtuara në rrjetin për ujitje dhe objekte tjera që i takojnë natyrës së punës së tij;
- Punon në mbushjen, ajrosjen dhe zbrazen e rrjetit për ujitje;
